
MODELI I POLICIMIT NË BASHKËSI NË SHKUP – NGA IDEJA NË REALITET

Autorë:
Kaltrina Selimi
Andreja Bogdanovski



Shkup 2015

analyticamk

www.analyticamk.org

Modeli i policimit në bashkësi në Shkup – nga ideja në realitet

Autorë:

Kaltrina Selimi
Andreja Bogdanovski

Dizajni: Muhsin Guler

Ky raport u përgatit nga hulumtues të Think Tankut Analitika (www.analyticamk.org) si pjesë e projektit hulumtues të përkrahur nga Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) **(www.dcaf.ch).**
Qëndrimet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet **e** Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF)**.**

Përmbajtja

1. Hyrje dhe metodologjia

2. Teorizimi i policimit në bashkësi

3. Konteksti i zhvillimit të policimit në bashkësi në Maqedoni

3.1. Ana ligjore e modelit të policimit në bashkësi

4. Aktorët (në bërjen) e policimit në bashkësi në Maqedoni

4.1. Këshilli Shtetror për Preventivë

4.2. Misioni i OSBE-së në Shkup

4.3. Ministria e Punëve të Brendshme (Policia) – Sektori për Punë të Brendshme Shkup

4.3.1. Projektet për Siguri – Klubet për Preventivë

4.3.2. Qendrat për Preventivë

4.4. Këshillat Lokal për Preventivë

4.5. Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve

4.6. Prezentim tabelar i analizës SWOT i modelit aktual të policimit në bashkësi në Shkup

5. Studim rasti: Komuna e Aerodromit, e Gjorçe Petrovit dhe e Çairit

5.1. Përfshirja e qytetarëve në çështjet e sigurisë

5.2. Siguria lokale

5.3. Njohuritë rreth policisë lokale

5.4. Niveli i kënaqësisë me punën e policisë

5.5. Informimi rreth çështjeve të bashkësisë lokale

6. Konkluzioni dhe rekomandime

LISTA E SHKURTESAVE

GKQ – Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve

OShC – Organizatat e Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi Evropian

KLP – Këshillat Lokal për Preventivë

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

OJQ – Organizatë joqeveritare

G.Z. – Gazeta zyrtare

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

SP – Stacioni policor

SPB Shkup – Sektori për Punë të Brendshme Shkup

SOS Fshatrat e fëmijëve – organizatë në Maqedoni që u ofron përkrahje fëmijëve që kanë humbur mundësinë për të jetuar me familjet e tyre biologjike

SUMNAL – organizatë për zhvillim dhe asocim të bashkësisë rome në Maqedoni

KB – Kombet e Bashkuara

USAID – Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar

1. Hyrje dhe metodologjia

Ky dokument i politikave vlerëson funksionalitetin e modelit të policimit në bashkësi në kryeqytetin e Maqedonisë, Shkup, duke analizuar strukturën dhe vënien në funksion të policimit në bashkësi të ushtruar në tri komuna: Aerodrom, Çair dhe Gjorçe Petrov. Për më tepër, ajo përfshin pikëpamjet nga vendi duke u mbështetur në anketa telefonike, grupe të fokusit dhe intervista personale, duke arritë në përgjigje se në çfarë mase është zhvilluar policimi në bashkësi në qytetin e Shkupit.

Më konkretisht, ai përpiqet të përcaktojë nivelin deri në të cilin është zhvilluar modeli i policimit në bashkësi. Kjo përfshin identifikimin e aspekteve, si: nëse policia ka inkorporuar procedura të reja të menaxhimit; nëse janë paraqitur struktura të reja trajnimi për policim të orientuar drejt bashkësisë; nëse janë miratuar ndryshime në strukturën organizative të forcave të policisë, dhe; deri në çfarë mase partneritetet polici/bashkësi janë zhvilluar. Gjithashtu shqyrton metodat dhe mjetet që policia i përdor për t'iu qasur bashkësive që u shërbejnë.

Dokumenti i politikave është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë ka të bëjë mënyrën se si është i organizuar policimi në bashkësi në Shkup, në cilat prioritete është përqendruar puna e policisë, kush i zbaton, çfarë funksionon në praktikë dhe çfarë jo. Përveç kësaj ai analizon në mënyrë kritike punën e trupave përgjegjëse për zbatimin e këtij koncepti (p.sh.:Këshillat Lokalë për Preventivë) dhe se si ato kontribuojnë në policimin në bashkësi në përgjithësi.

Pjesa e dytë vlerëson modelin e policimit në bashkësi në kushte reale përmes hulumtimit që përdor një qasje "nga poshtë-lart". Për këtë qëllim ne përdorëm metodën e studimit të rasteve, ku tri komuna në Shkup u përzgjodhën si mostër përfaqësuese. Njëra është me shumicë të popullsisë etnike maqedonase (Aerodromi), një me popullsi me shumicë shqiptare (Çairi) dhe e treta me popullsi të përzier etnike (Gjorçe Petrovi). Në lidhje me metodologjinë, pjesa e parë e hulumtimit mbështetet në informacione nga institucionet shtetërore dhe aktorët përkatës të marra përmes përdorimit të ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik, nga raportet vendore dhe ndërkombëtare mbi punën e policisë së Maqedonisë, ashtu si edhe intervista dhe artikuj mediumesh. Përveç kësaj, metodologjia e përdorur për ta shkruar këtë dokument politikash përfshin kërkim nëpër burime të hapura, analizë të thellë dhe rishikim të literaturës dhe raporteve ekzistuese.

Në një përpjekje për të kuptuar më mirë qëndrimet lokale të qytetarëve që jetojnë në këto komuna, një sondazh i opinionit me telefon u kry në tri komunat e lartëpërmendura ku 180 pyetësorë u ndanë në mënyrë të barabartë në secilën komunë. Përveç kësaj, tri grupe fokusi u organizuan me pjesëmarrës nga të tre komunat; secili grup fokusi kishte nga gjashtë pjesëmarrës, në të cilat të gjitha grupmoshat dhe gjinitë ishin të përfaqësuara në mënyrë të barabartë. Përgjigjet nga anketat dhe grupet e fokusit u përdorën për të portretizuar më mirë se si policimi në bashkësi shihet nga pikëpamja e një qytetari, me një përpjekje për të identifikuar disa nevoja urgjente dhe për të sugjeruar mënyra të reja për zhvillimin e mëtejshëm të policimit në bashkësi të cilat sugjerime do buronin drejtpërdrejtë nga qytetarët. për të hulumtuar tutje punën institucionale të këtyre tri komunave, u zhvilluan intervista me anëtarë nga komunat lokale, duke përfshirë këtu edhe Këshillat Lokalë për Preventivë, si dhe Sektorin e Punëve të Brendshme në Shkup në kuadër të policisë së Maqedonisë.

Përveç kësaj, statistikat e veprave penale për vitet 2012, 2013 dhe 2014 u analizuan

duke kryqëzuar me gjetjet kryesore nga sondazhi i opinionit; qëllimi ishte për të identifikuar nëse nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve adresohen në mënyrë adekuate përmes modelit aktual të policimit në bashkësi në qytetin e Shkupit dhe nëse ky model po arrin të ndërtojë një kanal efektiv të komunikimit ndërmjet qytetarëve, agjencive qeveritare, shoqërisë civile dhe policisë. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme, pasi koncepti i policimit në bashkësi vë theksin mbi partneritetet bashkëpunuese dhe transformimet organizative për parandalim më të mirë të krimeve dhe zgjidhje të problemeve.[1]

Për më tepër, u organizua edhe një tryezë e rrumbullakët që mblodhi të gjitha palët përgjegjëse për implementimin e policimit në bashkësi në Shkup, me të ftuar nga tri komunat e zgjedhura si raste për studim. Tryeza e rrumbullakët u ndoq edhe nga përfaqësues të zyrës së OSBE-së në Shkup, si dhe përfaqësues akademikë. Në një masë të madhe, përfundimet nga tryeza e rrumbullakët konfirmuan gjetjet tona dhe theksuan ide të reja për përmirësimin e mëtejshëm të modelit të policimit në bashkësi, që rrjedhin drejtpërdrejt nga aktorët e përfshirë për zbatim të këtij koncepti. Kjo paraqet një vlerë të shtuar të hulumtimit tonë dhe në mënyrë të konsiderueshme ka kontribuar në përfundimet e identifikuara në seksionin e rekomandimeve të këtij hulumtimi.

Për shkak të zbatimit të saj në kontekstin e Maqedonisë, policimi në bashkësi është kuptuar siç përcaktohet nga Misioni i OSBE-së në Shkup si "policim që në mënyre aktive përfshin bashkësinë ashtu që numri i krimeve të zvogëlohet, të parandalohen e herët të zbulohen"; paraqet një partneritet në mes policisë dhe bashkësisë për të siguruar se policia vazhdimisht ofron shërbime cilësore për popullin.[2]

1 " Policimi në bashkësi, i definuar" – Shërbime të orientuara kah policimi në bashkësi (COPS), Ministria e Drejtësisë e ShBA-ve, Uashington DC, së pari e botuar në 2012, e rishikuar në 2014.

2 Policimi në bashkësi ", planet mësimore të OSBE-së, Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup, në A. Dikici "Hyrje në policim multi-etnik në Maqedoni: Roli i OSBEsë". Uluslararası Hukuk ve Politika 3/10. fq. 141.

2. Teorizimi i policimit të bashkësisë

Si koncept, policimi në bashkësi mund të shihet së fundi si filozofi e policimit. Ajo u shfaq para së gjithash nga nevoja për të ndryshuar mënyrën se si kryhej policimi; kjo ishte për shkak të dështimit të mënyrës tradicionale të policimit duke u karakterizuar me organizim të centralizuar dhe burokratik, një formulim i cili nuk ishte në gjendje për të adresuar sfidat e shoqërisë së sotme – duke përfshirë edhe rritjen e mosbesimit ndaj policisë.[3]

Si koncept, ka fituar vëmendje nga komuniteti i hulumtuesve për shkak të ndryshimit drastik që ka pësuar nga përkufizimi nga një "model i centralizuar dhe burokratik në një model të decentralizuar dhe të hapur"[4], që autorët Trojanoviç (Trojanowicz) dhe Karter (Carter) paraqesin ndoshta një nga definicionet më të mira të policimit në bashkësi, që kap thuajse të gjitha elementet e tij. Ata e konsiderojnë atë si "filozofi dhe jo taktikë specifike; qasje proaktive dhe e decentralizuar, e dizajnuar për të reduktuar krimet, çrregullimin dhe frikën nga krimet, duke e vendosur policin e njëjtë në bashkësinë e njëjtë në afat të gjatë."[5]

Megjithatë, akademikët dekadave të fundit kanë manovruar me disa terma semantikë kur e përshkruajnë filozofinë e policimit në bashkësi. Konkurrenti kryesor në betejën e fjalëve është e ashtuquajtura "Policimi i orientuar kah problemi", që mund të shihet si plotësuese për policimin në bashkësi, por jo në mënyrë të domosdoshme duke e zëvendësuar atë plotësisht. Përfshirja e qytetarëve në modelin e policimit në bashkësi është parë mëse e nevojshme, ndërsa për policimin e orientuar kah problemi nuk është e patjetërsishme.[6]

Policimi në bashkësi ka pësuar shumë ndryshime përgjatë viteve, mirëpo paralelisht ka pasë përpjekje për ta zbatuar në zona dhe vende të reja që nuk kanë pasur përvojë më herët me të. Kjo veçanërisht ka qenë e dukshme në vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, ashtu si dhe në kontinentin afrikan. Megjithatë, nuk ka asnjë definicion apo shabllon se si duhet të funksionojë policimi në bashkësi. Policimi në bashkësi nëpër botë ka specifikat e veta implementuese, që do të thotë se mënyra anglo-saksone e bërjes së saj dallon nga mënyra amerikane apo Evropës kontinentale.

Shumë autorë e portretizojnë policimin në bashkësi si proces i udhëhequr nga Perëndimi për ta eksportuar si produkt të gatshëm. Majk Broxhen (Mike Brodgen) dhe Preti Nixhhar (Preeti Nijhar) e shpjegojnë këtë duke thënë se "policimi në bashkësi është i rëndësishëm... sepse është komponentë kyçe i një shtytësi të eksportuar nga Perëndimi në zhvillimin e strukturave të reja të policimit në shoqëritë tranzitive..."[7]

Për më tepër, eksportimi i policimit në bashkësi si filozofi dhe si proces reformimi tani po futet në masë të madhe në punën e organizatave ndërkombëtare, siç janë: KB, OSBEja, BEja etj. Kjo gjithashtu vlen edhe për Maqedoninë, ku fillimisht policimi në bashkësi si koncept u fut nga OSBEja në periudhën pas konfliktit të armatosur të vitit 2001.

---

3 Liou, Kuotsai Tom, dhe Eugene G. Savage. "Perceptimi i qytetarve për ndikimin e policimit në bashkësiRaporti tremujor i Administratës Publike, vëll. 20, nr. 2 (1996): 163.

4 Po aty. 164

5 Trojanowicz Robert C. and D. Carter (1988). "Filozofija dhe roli i policimit në bashkësi". East Lansing, MI: Shtypi i Universitetit Shtetëror të Miçiganit.

6 Michael D. Reisig. "Policimi në bashkësi dhe i orientuar kah problemi." Krimi dhe Drejtësia, vëll. 39, nr. 1 (2010): 9

7 Mike Brodgen and Preeti Nijhar (2013). "Modelet dhe qasjet vendore dhe ndërkombëtare të policimit në bashkësi" Routledge fq. 2 9A&sig=ANxTF1ku6RPuUiiO8eoGH8YjjNE&redir_esc=y#v=onepage&q&f=false fq. 2.

Si i tillë, policimi në bashkësi ka rol të veçantë për të luajtur në shoqëritë e dështuara, tranzitive dhe paskonfliktuoze, ku policia pëson ndryshime të mëdha për t'u bërë më e ndjeshme ndaj nevojave të banorëve lokalë. Zigeri (Zieger) dhe Nildi (Neild) (2002) të cituar te M. Brixheni dhe P. Nixhhari (2013: 4) e shohin instalimin e policimit demokratik si themel për sigurinë dhe stabilitetin e nevojshëm për konsolidimin e demokracisë dhe për një mjedis më të pjellshëm për zhvillim ekonomik.[8]

3. Konteksti i zhvillimit të policimit në bashkësi në Maqedoni

Koncepti i policimit në bashkësi në Maqedoni është i lidhur ngushtë me ndryshimet e tërësishme të dukjes politike dhe institucionale që ka dalë nga përvetësimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, një marrëveshje për ndarje të pushtetit që përfundoi konfliktin e brendshëm të armatosur në Maqedoni në vitin 2001.

Përveç ndërprerjes së armiqësive, ajo gjithashtu filloi një gamë të gjerë të reformave të të gjitha segmenteve të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë sektorin e sigurisë së Maqedonisë. Pasojat e vitit 2001 dhe Marrëveshja e Ohrit hodhën themelet për qeverisje dhe institucione që kanë qasje më të ndjeshme ndaj etniteteve tjera në Maqedoni, duke përfshirë punësime që reflektojnë përfaqësim multi-etnik në forcat e policisë që më mirë do të adresonin nevojat e të gjitha bashkësive që jetojnë në Maqedoni. Përveç kësaj, një nga komponentat kryesorë të kësaj marrëveshjeje ishte decentralizimi komunal prej të cilit përfituan të gjitha bashkësitë në mënyrë të barabartë.

Duke marrë parasysh situatën e brishtë pas konfliktit dhe përpjekjet për përfaqësim më të barabartë të bashkësive pakicë, sektori i sigurisë së Maqedonisë, veçanërisht policia, në vitet e pas konfliktit, ishte në qendër të vëmendjes. Për këtë arsye, në fillim të viteve 2000 kishte një shtysë për policinë për të rifituar përsëri besimin dhe respektin e popullatës; kjo rezultoi në një proces gjithëpërfshirës të reformave, duke përfshirë një dukshmëri në rritje të policisë dhe patrullim etnikisht të përzier.

Forcat e përziera të policisë mendohet të kenë ndikim më të madh në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, si dhe fitimin e besimit reciprok në mes qytetarëve dhe policisë, duke çuar në rritje të bashkëpunimit.[9] Nevoja e njësive policore të përziera të cilat korrespondojnë me demografinë e rajoneve të caktuara në Maqedoni edhe më tej hapi rrugën për të përqafuar policimin në bashkësi si koncept. Ky koncept gjithashtu duhet të shihet si një pasqyrim i bashkësive lokale që u shërbejnë në përpjekje për të arritur një performancë optimale.

Për më tepër, policimi në bashkësi mund të ndihmojë të krijojë një sistem të paralajmërimit të hershëm, i cili mund të rezultojë në një normë më të lartë të raportimit të krimeve. Angazhimi i qytetarëve dhe pjesëmarrja e tyre në projekte dhe fushata parandaluese, mund të kontribuojë në lagje më të sigurta dhe të një kulture të përgjithshme të sigurisë. Decentralizimi gradual i kompetencave policore në nivel lokal reflekton përpjekjet për të kapërcyer hendekun mes policisë dhe komuniteteve lokale.[10]

---

8 Po aty, 4

9 Policimi i bashkësisë multikulturore – H I DeGeneste; J P Sullivan, Forumi Ekzekutiv Hulumtues i Policisë, NW, 1997

10 C. Koneska "Maqedonia: analizë kontekstuale e reformave të sektorit të sigurisë në Maqedoni 1991-2008" http://analyticamk.org/images/stories/files/cassrm_mk.pdf; fq.19, Shkup, 2011

3.1. Ana ligjore e modelit të policimit në bashkësi

Policimi në bashkësi nuk ka vend të caktuar posaçërisht në legjislacionin primar të Maqedonisë. Pjesa më e madhe e tekstit që rregullon policimin në bashkësi është i shpërndarë nëpër strategji dhe dokumente të ndryshme.

Për shembull, Ligji për Policinë[11] – i miratuar në vitin 2006 – standardizon policimin në bashkësi me nenin 11 (pa e përdorur në mënyrë specifike termin policim në bashkësi), që detyron policinë të punojë me qytetarët, shoqatat dhe persona të tjerë juridikë, të bashkëpunojnë me autoritetet e të gjitha komunave, në veçanti me atë të Shkupit, me qëllim për të përmirësuar sigurinë dhe për të parandaluar dhe zbuluar krimet dhe kundërvajtjet. Ligji për Policinë obligon policinë të bashkëpunojë me bashkësinë, por nuk bënë dallimin midis policisë tradicionale dhe policimit në bashkësi. Ky artikull i ligjit shërben si bazë në mënyrë që institucionet e policisë të mund të zhvillojnë më tej një model të policimit në bashkësi.

Duke pasur intervenime sporadike në segmentin legjislativ implementimin e policimit në bashkësi e bën më të vështirë. Mungesa e dispozitave të qarta ligjore, veçanërisht në segmentin që mbulon marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe komunave lokale mbi çështjet e policimit në bashkësi u jep, nga njëra anë, fleksibilitet komunave lokale, por, nga ana tjetër, e bën shumë arbitrare për autoritetet lokale se si të angazhohen me policinë në çështjet që prekin sigurinë lokale. Linja të veçanta buxhetore në buxhetet e komunave lokale të dedikuara për qëllimin e zhvillimit të policimit në bashkësi në Maqedoni gjithashtu mungojnë, që komplikon më tej zbatimin e këtij koncepti.

Ka pasur përpjekje për të adresuar këtë çështje duke miratuar udhëzime për rregullimin e metodave dhe mjeteve të punës parandaluese nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 2013. Përpjekja ishte për të definuar rolin e Këshillave Lokalë për Preventivë (KLP) në fushat e: koordinimit të bashkësive lokale, zbulimin e shqetësimeve rreth sigurisë, përcaktimin e politikës së punës dhe ndërtimin e strategjive për zgjidhjen e problemeve lokale, si dhe veprimet e përbashkëta dhe plane të punës me policinë për zgjidhje specifike.[12]

Kjo më tej shkon në përcaktimin e detyrave specifike që do të ndërmerreshin nga KLPtë. Kjo përfshin: mbledhjen e ankesave dhekërkesave nga ana e popullatës lokale, shkëmbimin e informacionit me të gjithë anëtarët që kanë qasje në informata konfidenciale të caktuara, analiza e ndikimit të problemeve të caktuara, vlerësimin e nevojave dhe përcaktimin e politikës së punës, vlerësimin e rezultateve të arritura në mënyrë periodike dhe, kur është e nevojshme, ripërshtatjen e planeve të veprimit, vlerësimin e rezultateve përfundimtare etj.

Përkundër kësaj, gjatë aktiviteteve tona kërkimore nuk mund të identifikonim ndonjë shkrim/raport të publikuar nga Këshillat Lokalë për Preventivë që adresojnë ndonjë nga detyrat e lartpërmendura.

11 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 114/2006, ndryshimet në Gazetën Zyrtare nr. 145/2012 dhe Gazetën Zyrtare nr. 41/2014

12 Udhëzime për rregullimin e metodave dhe mjeteve të punës preventive, si dhe planifikimin dhe regjistrimin e aktiviteteve parandaluese, Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë, Shkurt 2013

4. Aktorët (në bërjen) e policimit në bashkësi në Maqedoni

Edhe pse policimi në bashkësi nuk është përcaktuar zyrtarisht në legjislacionin primar (p.sh.: Ligji për Policinë apo Rregullorja e Punës), mënyra në të cilën ajo ushtrohet (duke përfshirë edhe qytetin e Shkupit) ka treguar se bëhet përmes disa pikave kryesore të hyrjes. Këto përfshijnë: Këshillin Shtetëror për Preventivë, Ministrinë e Punëve të Brendshme (Sektori për Punë të Brendshme), Këshillat Lokalë për Preventivë, Grupet Këshilldhëndëse të Qytetarëve dhe Qendrat për Preventivë. Këtu bëjnë pjesë edhe projektet e ndryshme të sigurisë, siç është projekti "Klube për Preventivë". Disa kanë tendencë për të treguar rezultate më të mira se të tjerët.

Për shembull, edhe pse ata janë përballur me shumë sfida, Këshillat Lokalë për Preventivë tregojnë rezultate më të mira se Këshilli Shtetëror për Preventivë. Përderisa mekanizmat implementuese janë paraparë me futjen e policimit në bashkësi në Shkup, ato ende nuk njihen plotësisht nga qytetarët. Prandaj, ka nevojë për më shumë fushatë mbi ekzistencën e mekanizmave aktuale, duke punuar në drejtim të institucionalizimit dhe standardizimit të policimit në bashkësi në përgjithësi.[13]

4.1. Këshilli Shtetror për Preventivë

Këshilli Shtetror për Preventivë është trupi kryesor koordinues i cili përcakton prioritetet kombëtare dhe siguron zbatimin e duhur të konceptit të policimit në bashkësi në Maqedoni. Ky këshill u krijua për herë të parë në vitin 200814 dhe anëtarët e saj janë zyrtarë të nivelit të lartë, si Kryeministri, Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Ministri i Arsimit, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave dhe Ministri i Vetëqeverisjes Lokale. Në mungesë të Kryeministrit, Këshilli Shtetror për Preventivë kryesohet nga Ministri i Punëve të Brendshme. Sipas dokumenteve ligjore, vendimi për themelimin e këtij organi lejon Organizatat e Shoqërisë Civile të marrin pjesë në aktivitetet e saja.

Edhe pse detyrohen të takohen të paktën dy herë në vit15, nuk ka asnjë informacion publik rrethnumrit të mbledhjeve të mbajtura dhe agjendës respektivisht. Duke marrë parasysh se në disa vitet e fundit ka pasur një rritje të dhunës nëpër komuna të ndryshme në Shkup, e cila shpeshherë kishte potencial për të ndezur tensionet ndëretnike, duke mos pasur informacion në lidhje me aktivitetet e këtij organi vë në pikëpyetje qëllimin e ekzistimit të saj. Disa nga pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët shprehën shqetësimet e tyre se ky këshill nuk është plotësisht funksional në praktikë.

13 Gjetje nga diskutimi i tryezës së rrumbullakët të mbajtur më 22 qershor 2015.

14 Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë ndaj Informacioneve Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 110/14.

15 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 133/2008

4.2. Misioni i OSBE-së në Shkup

Misioni i OSBE-së në Shkup ka qenë një nga aktorët më të rëndësishëm në lidhje me vënien e fillimit të idesë dhe krijimin e policimit në bashkësi në Maqedoni, duke përfshirë edhe në qytetin e Shkupit. Pjesa më e madhe e mandatit të tanishëm të OSBE-së buron nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në vitin 2001, prandaj u morr m zbatimin e një sërë masash për ndërtim të besimit të ndërsjelltë16, si

- ripozicionimi i policisë në ish-rajonet e krizës;
- reformimi dhe trajnimi i policisë, duke përfshirë trajnimin e zyrtarëve të rinj policorë nga komunitetet etnike pakicë;
- forcimi i institucioneve të vetëqeverisjes lokale;
- ofrimi i ndihmës dhe zbatimi i projekteve në fushat e sundimit të ligjit dhe zhvillimit të mediumeve;
- Sigurimi i përfaqësimit të barabartë të komuniteteve pakicë në polici, gjyqësi, administratë publike, ushtri, mediume dhe në ndërmarrje publike; dhe
- Përpjekjet e vazhdueshme në projektet për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, duke përfshirë edhe në fushën e arsimit.

Këtu mund të shohim idenë bazë për krijimin e strukturave të policisë në bashkësi, si pjesë e strategjisë më të gjerë të reformës policore në Maqedoni. Ideja e policimit në bashkësi u paraqit për herë të parë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme në nëntor të vitit 2001.[17]

Misioni i OSBE-së në Shkup filloi përgatitjet fillestare menjëherë pas përfundimit të konfliktit dhe nuk nxituan për ta përshpejtuar zbatimin e saj, por faktikisht e zbatoi atë nëpërmjet zhvillimit të një qasjeje me dy shtylla në një hapësirë kohore prej dhjetë vjetësh. Shtylla e parë është puna e OSBE-së me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa e dyta mund të shihet në bashkëpunimin me komunat lokale në lidhje me policimin në bashkësi. OSBE-së iu desh më pak se një dekadë për të arritur në thelbin e policimit në bashkësi me promovimin dhe krijimin e Këshillave Lokalë për Preventivë, Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve.

Në vitet e para që kanë të bëjnë me trajnimin dhe zbatimin, OSBE-ja u përqëndrua në trajnimin e zyrtarëve të MPB-së për themeet e filozofisë së policimit në bashkësi në mënyrë që të siguronte se ajo do mishërohet në etosin e punës së MPB-së.[18]

Një nga arritjet më të mëdha të OSBE-së, kur është fjala për policimin në bashkësi, mund të shihet nëpërmjet krijimit të inspektorëve për preventivë si pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme/ strukturës policore, diçka që nuk ka ekzistuar më parë dhe lidhet direkt me çështjet e policimit në bashkësi.[19] Pjesa më e madhe e mbështetjes së dhënë nga OSBE-ja përbëhet nga ofrimi i trajnimeve, duke punuar në përfshirjen e këtyre strukturave

16 OSBE, fleta me fakte e OSBE-së – Misioni Vëzhgues në Shkup
17 Intervistë me përfaqësues nga Misioni i OSBE-së në Shkup, 15 korrik 2015
18 Intervistë me përfaqësues nga Misioni i OSBE-së në Shkup, 15 korrik 2015
19 Po aty.

brenda MPB-së përmes mbështetjes së sistematizimit të këtyre vendeve të reja, duke sjellë ekspertizë, përkrahje buxhetore etj.[20]

Përpjekjet janë bërë edhe në nivel lokal; kjo përfshinte futjen e këshillave lokalë për preventivë dhe grupeve këshilldhënëse të qytetarëve, të cilat janë zemra e modelit të policimit në bashkësi. Megjithatë, ka pasur rezultate të përziera rreth performancës së këtyre strukturave, pasi disa prej tyre ende nuk janë plotësisht të qëndrueshme.[21]

Një nga sfidat kryesore që OSBE-ja po përballej në nxitjen e kësaj reforme është ndikimi që zgjedhjet lokale e kanë në performancën e këtyre strukturave për shkak të politizimit. Me fjalë të tjera, disa komuna rifillojnë nga zeroja në ngritjen e këshillave të rinj lokalë për preventivë për shkak të rezultateve të zgjedhjeve me ndrrimin e kryetarve me çka rrezikojnë humbjen njohurive institucionale nga këshilli i mëparshëm më çka e vonojnë të gjithë procesin e funskionimit të këtyre këshillave.[22]

Që nga viti 2013 OSBE-ja ka pushuar të jep mbështetje për këshillat lokalë për preventivë, si dhe për grupet këshilldhënëse të qytetarëve. Arritja e një niveli të mjaftueshëm të vetëqëndrueshmërisë – veçanërisht në segmentin e bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (shtylla e parë) – është arsyeja kryesore që misioni i Shkupit është në proces të tërheqjes nga mbështetja aktive në punën e policimit në bashkësi në Maqedoni. Edhe pse OSBE-ja ka ndërprerë mbështetjen formale, ajo vazhdon të jetë e angazhuar në aktivitete të policimit në bashkësi në mënyrë indirekte, përmes programeve të tjera të reformave policore.[23]

4.3. Ministria e Punëve të Brendshme (Policia) – Sektori për Punë të Brendshme, Shkup

Ministria e Punëve të Brendshme – përmes Sektorit për Punë të Brendshme – është pa dyshim një nga faktorët më të rëndësishëm përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e konceptit të policimit në bashkësi. Një nga arsyet për një supozim të tillë mund të merret nga fakti se komunat lokale ende nuk kanë buxhete të caktuara posaçërisht për qëllime të policimit në bashkësi, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme ka të dy mjetet financiare dhe logjistike për të punuar në këtë fushë.

Departamenti për Preventivë është njësi organizative në kuadër të Sektorit për Punë të Brendshme që ka një rol të madh kur kemi të bëjmë me policimin në bashkësi. Në fakt, çdo stacion policor në Shkup ka të punësuar një inspektor për preventive, i cili i koordinon aktivitetet e Departamentit për Preventivëdhe komunave.

Puna e Departamentit për Preventivë kryesisht përbëhet nga zhvillimi i strategjive vjetore për preventivë dhe organizimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes. Strategjia vjetore për preventivë merr në konsideratë raportet e krimit të prodhuara nga Departamenti për Analizë në kuadër të Sektorit të Punëve të Brendshme. Kështu, autoritetet janë më shumë të aftë për t'i adresuar rreziqet potenciale dhe për të ndërmarrë masa parandaluese me kohë; gjithashtu cakton masa për zbulim të hershëm të rreziqeve të sigurisë dhe zhvillon prioritetet për punë të departamenteve për preventivë në kuadër të Sektorëve të Punëve të Brendshme në tërë territorin e Maqedonisë.

20 Po aty.
21 Po aty.
22 Po aty.
23 Po aty.

Komuna lokale zgjedh/cakton Komandirnin e stacionit të policisë lokale në komunat e tyre. Çdo gjashtë muaj, apo edhe më shpesh nëse ka nevojë, Komandiri i stacionit lokal të policisë i raporton kryetarit të komunës, ashtu si edhe përfaqësuesve të zgjedhur komunalë, ku operojnë njësitë policore. Kështu, mund të nxjerrin përfundime së bashku dhe të përgatisin planet punuese për parandalimin e krimit. Anëtarët e këshillit komunal, së bashku me kryetarin e komunës, pastaj votojnë në raportin dyvjetor të policisë, që i jep rekomandime policisë rreth zonave prioritare, ku kanë nevojë të përqendrohen në gjashtë muajt e ardhshëm. Megjithatë, nuk ka mjaft informacione rreth normës së zbatimit të këtyre rekomandimeve nga policia dhe as nuk ka raporte në dispozicion për konsum publik në uebfaqet e komunave.

Sektori për Punë të Brendshme gjithashtu organizon fushata të ndryshme në të gjitha klubet ekzistuese shoqërore nëpër Shkup – siç është klubi i pensionistëve – për të ngitur vetëdijen se si të moshuarittë mbrojnë veten nga sulmime apo plaçkitje, sepse ka një numër të rritur të sulmeve ndaj të moshuarve në orët e hershme të mëngjesit. Fushatat tjera përfshijnë aktivitete për ngritjen e vetëdijes se si të parandalohen plaçkitje në banesa, plaçkitje të motocikletave etj. Fushatat janë bërë në bashkëpunim me autoritetet lokale për t'i udhëzuar qytetarët se si ta mbrojnë veten dhe si të jenë më të vëmendshëm.

Në periudhën e verës, fushatat janë të përkushtuar për tema, si parandalimi i zjarreve, ndërsa gjatë pushimeve të dimrit fushatat përqëndrohen në ndalimin e përdorimit të pasigurt të mjeteve piroteknike apo vozitjeve të pasigurtaetj.

Përveç zhvillimeve të strategjisë dhe fushatave parandaluese, Sektori i Punëve të Brendshme në Shkup është gjithashtu përgjegjës për trajnimin e policëve në fushën e parandalimit. Sesionet e trajnimit zakonisht zgjasin 1-2 ditë dhe në vitin 2013 dhe 2014 kjo nismë trajnoi 200 sosh.24 Megjithatë, plani strategjik për vitet 2013-2015 në rritjen e bashkëpunimit dhe besimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve ishte caktuar si një dokument i klasifikuar. Çdo nivel i klasifikimit për një dokument të tillë – dhe veçanërisht për një dokument i cili ka për qëllim të drejtpërdrejtë qytetarët si përdorues përfundimtarë të tij – mund të shihet si problematike, kryesisht për shkak se qytetarët dhe aktorët e tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në policimin në bashkësi do të mund vetëm të përfitonin nga të pasurit këto dokumente në dispozicion për përdorim publik.

Prioritetet për Departamentin e Parandalimit, SPB Shkup për 2015[1]
- Parandalimi i plaçkitjeve të rënda
- Luftimi i trafikimit të drogës
- Parandalimi i varësisë nga droga
- Parandalimi i të gjitha formave të prishjes së rendit publik dhe paqes të ndjekur me përdorim dhune
- Parandalimi i delikuencës tek të miturit dhe sjelljes sociopatike ndër të rinjtë

24 Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë të Informacioneve Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 139/14.

Modeli i policimit në bashkësi i përdorur në Shkup gjithashtu do të përfitonte shumë nga riorganizimi i bashkëpunimittë marrëdhënieve në mes administratëstë komunave lokale dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në aspektin e kompetencave dhe resurseve, që në këtë pikë trajtohet me fleksibilitet të konsiderueshëm. Qasja e segmentuar krijon pengesa për kanalet që qytetarët mund t'i përdorin për të punuar së bashku me policinë në bërjen e bashkësive të tyre më të sigurta; një qasje më e përqendruar do të sjellë përdorim më efikas të burimeve të kufizuara.

Sipas pjesëmarrësve të tryezës së rrumbullakët, një shqetësim i madh që pengon punën e Këshillave Lokalë për Preventivë është mungesa e procedurave të qarta të punës dhe planeve të veprimit/strategjisë nga Sektori për Kontroll të Brendshëm Shkup ose të Ministrisë së Punëve të Brendshme përkundrejt policisë dhe komunave lokale. Ekziston një mungesë e vizionit se si të zhvillohen më tej këto këshilla dhe si të kapen nevojat e bashkësisë në mënyrë efektive.[25]

Megjithatë, riorganizimi nuk do të thotë unifikim i policimit në bashkësi rreth qytetit të Shkupit. Çfarë është e nevojshme në Gjorçe Petrov mund të mos jetë e nevojshme në Aerodrom ose Çair dhe anasjelltas; për këtë arsye, policimi në bashkësi duhet të përshtatet sipas nevojave të bashkësive.[26] Ajo duhet të shihet më shumë si një strategji për të zgjidhur çështjet e sigurisë lokale dhe si dhe të veprave penale më pak serioze ose mund të përdoret për mbledhjen e informacionit në mesin e bashkësive lokale.

4.3.1. Projektet për Siguri – Klubet për Preventivë

Një shembull i një iniciative që sjell policia afër të rinjëve është projekti "Siguria në shkolla", i zbatuar në bashkëpunim në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme (Departamenti për Preventivë) dhe Misioni i OSBE-së në Shkup. Projekti ka filluar në vitin 2011/2012 në disa shkolla të mesme dhe u vazhdua pas vlerësimit të suksesshëm.27 Edhe pse qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i sigurisë në shkolla dhe zvogëlimi i delikuencës së të miturve, si parim natyra e aktiviteteve të projektit sjell policinë më afër popullatës më të re.

Departamenti për Preventivë i Sektorit për Punë të Brendshme zhvilloi projekt plane dhe organizoi aktivitete që ishin të fokusuara në rininë me rrezik të lartë që kishte një mundësi më të madhe të bien nën ndikime të këqija. Këto plane të projektit janë zhvilluar bazuar në raportet e krimeve të mëparshme dhe analizave e mbledhura nga Departamenti për Analitikë, në kuadër të SPBsë.28Grupet kryesore të synuara janë shkollat fillore dhe të mesme në Shkup dhe aktivitetet kryesore përfshijnë themelimin e klubeve preventive, në mënyrë që të kryhen seminare mbi tema të tilla si: të drejtat e njeriut, roli i policisë në shoqërinë demokratike, dhuna në sport etj.29 Përpos studentëve, grupet punuese gjithashtu përfshijnë OJQtë lokale dhe organizata ndërkombëtare, siç është Fshati i Fëmijve SOS, SUMNAL, USAID, OSBE.[30]

25 Gjetje nga diskutimi i një tryeze të rrumbullakët të mbajtur më 22 qershor 2015.
26 Gjetje nga diskutimi i një tryeze të rrumbullakët të mbajtur më 22 qershor 2015.
27 OSBE Shkup: Misioni i OSBE-së në Shkup për vazhdimin e projektit "Siguria në shkolla" në dispozicion në http://www.osce.org/skopje/94516 last accesses 04.06.2015
28 Intervistë me Risto Jovanovskin, inspektor në Departamentin e Sektorit për Punë të Brendshme Shkup, e bërë në mars të vitit 2015.
29 Ministria e Punëve të Brendshme: Projekti "Siguria në shkolla" në dispozicion në: http://www.mvr.gov.mk/vest/35, herën e fundit që është shikuar ka qenë më 04.06.2015.
30 Po aty.

Grupet punuese në Klubet për Preventivë përbëhen nga trajnues profesionist, përfaqësues të këshillit të prindërve, një përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit në qytetin e Shkupit, si dhe zyrtarë të emëruar të komunës që përfaqësojnë sektorin e arsimit.

Këto grupe përgatisin planet e punës, koordinojnë aktivitetet në shkollë për monitorimin e sjelljeve të pahijshme të individëve ose grupeve në shkolla, në një përpjekje për të parandaluar delikuencën e hershme.[31] Takimet e këtyre grupeve janë çdo muaj gjatë vitit shkollor; përveç të pranishmëve lartpërmendura, në takime marrin pjesë edhe mësuesit, Inspektori për Preventivë – i cili është polic – dhe inspektori për delikuencë të të miturve, në bashkëpunim me Departamentin e Preventivës të SPBsë Shkup.

Megjithatë, shkollat e përzgjedhura vetëm brenda disa komunave janë pjesë e këtij projekti. Për shembull, nga tri komunat e rasteve të studiuara, vetëm komuna e Aerodromit ka klube të tilla prevenuese.[32] Në Gjorçe Petrov dhe Çair, klube për preventivë ende nuk janë formuar dhe takime të tilla në mes të policisë dhe nxënësve ndodhin vetëm kur zbatohen disa fushata të dedikuara; megjithatë, nuk ka ndërveprime të planifikuara rregullisht.[33] Sondazhet e opinionit dhe grupet e fokusit e kryera në këto tri komuna treguan se delikuenca e të miturve është identifikuar si një problem sigurie mes qytetarëve vetëm në komunën e Aerodromit; kështu, vendimi për të krijuar klubet prevenuese në shkollat e Aerodromit mund të kuptohet në vijë të nevojave të situatës sesa zbatim sistematik.[34] Megjithatë, kjo nuk duhet të përjashtojë dy komunat tjera, atë të Çairit dhe të Gjorçe Petrovit, të cilat – për dy vitet e fundit – kanë qenë pjesë e përleshjeve të dhunshme[35] ndërmjet policisë dhe popullatës, që në masë të madhe përfshijnë rininë e këtyre bashkësive.

4.3.2. Qendrat për Preventivë

Një tjetër metodë për parandalimin e krimeve dhe krijimin e lidhjeve më të ngushta midis qytetarëve dhe policisë është futja e Qendrave për Preventivë në komunat dhe bashkësitë urbane dhe rurale lokale. Qendra e parë e tillë është themeluar në Komunën e Gazi Babës (Maxhari) në tetor 2014 dhe zona rurale e kësaj komune gjithashtu fitoi një qendër të tillë në prill 2015.[36] Ministria e Punëve të Brendshme ka hapur edhe një Qendër për Preventivë në Gjorçe Petrov. Kjo Qendër për Preventivë është e vendosur në qendrën për kulturë të Gjorçe Petrovit dhe organizon dy takime në muaj me qytetarë për të diskutuar një gamë të gjerë temash, duke filluar nga dhuna në familje deri tek ato të varësisë. Një herë në javë, qytetarët kanë një "ditë të hapur" në qendër ku ata mund të planifikojnë një takim individual me ndonjë polic të stacionit policor lokal.[37]

31 Intervistë me RistoJovanovskin, SPB Shkup.

32 Po aty.

33 Intervistë me Sabit Shabanin, anëtar i Këshillit të Komunës së Çairit, e bërë më 7 maj 2015, në Shkup; dhe intervistë me anëtarin e Këshillit Lokal për Parandalim të Gjorçe Petrovit në mars të vitit 2015.

34 Sondazh telefonik, në komunën e Aerodromit 60 njerëz u intervistuan, në pyetjen se cili është problemi më i madh për sigurinë e tyre në zonën ku jetojnë, 5% e zgjedhin delikuencën e të rinjve si një nga problemet me të cilat ballafaqohen.

35 Protesat shqiptare vazhdojnë në Maqedoni, Top Çanëll, 11.07.2014 – http://www.top-channel.tv/english/artikull.php?id=12286; Aksioni i policisë maqedonse është vënë në pikëpyetje në trazirat etnike – Ballkan Insajt (Balkan Insight), 23.05.2014 – http://www.balkaninsight.com/en/article/skopje-calm-after-ethnic-riots-over-murder

36 Bazuar në bashkësinë lokale të Stajkovcit.

37 Intervistë me Risto Jovanovskin, inspektor në Departamentin për Preventivë të Sektorit për Punë të Brendshme në Shkup, e bërë në mars të vitit 2015.

Rëndësia e këtyre qendrave është se ato u ofrojnë qytetarëve një mundësi për të diskutuar problemet e sigurisë me policinë në mënyrë specifike në lidhje me lagjen e tyre apo njësinë e tyre vendore, pa nevojën për të adresuar çdo gjë në një nivel më të gjërë komunal. Kjo është veçanërisht e dobishme në zonat rurale, të tilla si fshatrat që bien nën Komunën e Gjorçe Petrovit, por territorialisht nuk janë aq afër ndërtesës së komunës; si të tilla, ato janë duke ofruar mundësi për të adresuar çështjet që janë vetëm specifike për njësitin e tyre rural.[38]

Edhe pse këto qendra janë themeluar, ekziston një mungesë e ndërgjegjësimit të situatës në nivel lokal. Siç e kemi mbledhur mendimet nga anekta i jonë dhe grupeve të fokusit, nuk është e qartë se si këto qendra tërheqin vizita nga qytetarët. Koncepti i bashkëpunimit dhe angazhimit polic-qytetar nuk është i njohur gjerësisht, dhe roli i policisë ende perceptohet nga qytetarët si tradicional - që është, vetëm në kuadër të zbatimit të ligjit.

4.4. Këshillat Lokalë për Preventivë

Ideja për themelimin e Këshillave Lokalë për Preventivë ka origjinën nga përfshirja e OSBE-së në programin e policimit në bashkësi në Maqedoni. Ajo u prezantua për herë të parë në vitin 2007 me qëllim për të siguruar mbështetje të gjerë institucionale dhe mbështetetje nga qytetarët për një model të policimit në bashkësi.[39]

Këshillat Lokalë për Preventivë – së bashku me Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve – janë ndoshta forma më e afërt e institucionalizimit të policimit në bashkësi në Maqedoni. Qasjet e strukturuara mirë, sidomos kur bëhet fjalë për Këshillat Lokalë për Preventivë, kanë ndjekur një model që ofron platformë të shëndoshë për diskutimin e temave të rëndësishme për çështjet lokale të sigurisë. Këto zakonisht përbëhen nga anëtarë të këshillit komunal lokal, nga anëtarë të policisë lokale dhe – varësisht nga tema e diskutimit – anëtarë nga ministritë e ndryshme, si ministria e arsimit dhe shkencës ose e punës dhe politikës sociale. Kryetari i komunës është kryesuesi i këtij këshilli dhe të gjithë përfaqësuesit e ministrive në këshill duhet të bashkëpunojnë me të në nivel lokal.[40]

Nuk ka asnjë kuotë minimale kur bëhet fjalë për numrin e mbledhjeve që duhet të mbahen. Megjithatë, për shkak të një sërë arsyesh që do të diskutohen më poshtë, kjo mund të jetë problematike pasiqë disa Këshilla Lokalë për Preventivë nuk takohen fare, ndërsa të tjerët – si në rastin e Gjorçe Petrovit – kanë lënë rezultate të takimeve dy herë në vit. Përveç kësaj, në rastin e Gjorçe Petrovit ka raste kur organizatat e shoqërisë civile janë ftuar nëpër takime që është diçka që duhet të bëhet praktikë e zakonshme e jo diçka e rastit.

Në periudhën prej 2010-2014, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme Këshillat Lokalë për Preventivë u formuan në të gjitha komunat në Shkup41, dhe në vitin 2013 pas zgjedhjeve lokale MPB inicoi një rifillim të këshillave lokale për preventivë me anëtarët e rinj komunalë.[42]

38 Intervistë me anëtar të Këshillit Lokal për Parandalim të Komunës së Gjorçe Petrovit e bërë në mars të vitit 2015.
39 Intervistë me përfaqësues nga Misioni i OSBE-së në Shkup, 15 korrik 2015.
40 Bazat e policimit parandalues, Rozalita Dojçinovska, Departamenti për Preventivë, SPB Shkup, 2013
41 Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 117/14.
42 Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 108/14.

Duke i pasur marrëdhëniet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe komunave lokale të parregulluara me mandate të qarta krijon konfuzitet në këtë fushë. Për shembull, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme,anëtarët e Këshillave Lokale për Preventivë zgjidhen pas çdo cikli zgjedhor, ndërsa komuna e Çairit zhvillon zgjedhje në baza vjetore. Megjithatë, Komuna e Gjorçe Petrovit nuk vuan nga ndërrime të mëdha në strukturë për shkak të mandateve të njëpasnjëshme të kryetarit aktual dhe mbështetjen e gjerë që ai aktualisht gëzon në mesin e publikut.

Ka mospërputhje të dukshme në përgjigjet që kemi marrë nëse komunat kanë themeluar Këshilla Lokalë për Preventivë. Përderisa Ministria e Punëve të Brendshme janë përgjigjur se të gjitha komunat në qytetin e Shkupit kanë krijuar këshillat lokalë për preventivë, kjo nuk korrespondon me përgjigjet nga Komuna e Aerodromit, që sinjalizuar se ata ende nuk kanë formuar një këshill të tillë.43

Megjithatë, ka një gatishmëri në komunën e Aerodromit për të formuar një këshill të tillë sipas një punonjësi të kësaj komune. Ai madje e përshkroi bashkëpunimin e komunës me policinë si shumë të lartë. Duke qenë se është kështu, mbetet e paqartë se pse ende komuna nuk ka qenë e angazhuar më aktivisht në krijimin e këtij këshilli pduke marrë parasysh faktin se nuk janë identifikuar pengesa të mëdha.44

Komuna e Aerodromit gjithashtu ka zhvilluar mjete shtesë45 që ua mundëson qytetarëve të parashtrojnë ankesat e tyre me garancion se përgjigje do të marrin brenda 48 orëve.46 Disa nga ankesat që ata marrin kanë të bëjnë me problemet komunale si ndriçimi i dëmtuar i rrugëve, që në mënyrë indirekte mund të shihet edhe nga pikëpamja e sigurisë.

Në anën tjetër, Komuna e Çairit ka formuar një Këshill Lokal për Preventivë dhe ka katërmbëdhjetë anëtarë që vijnë nga fusha të ndryshme të ekspertizës, siç janë arsimi, sporti, shëndetësia, kultura, media e zjarrfikësit, si dhe anëtarë nga këshilli i komunës dhe stacioneve policore lokale.

Në lidhje me shpeshtësinë e mbledhjeve, Këshillat Lokalë për Preventivë në Çair mesatarisht takohen 2-3 herë në vit, në të cilin çështjet e sigurisë në përgjithësi janë më të shquara në rendin e ditës.47

Megjithatë, takime të tilla në Gjorçe Petrov janë identifikuar si më të shpeshta dhe efektive, ku masa konkrete për përmirësim jmiratohen pas çdo takimi. Këshilli Lokal për Preventivë në Gjorçe Petrov ka dhjetë anëtarë që mbulojnë fushat e arsimit, sportit dhe shëndetit, si dhe anëtarët e tjerë janë kryeshefi i stacionit të policisë lokale, kryeshefi i departamentit të zjarrfikësve, një përfaqësues nga zyra e prokurorit publik si dhe Kryetari i Komunës së Gjorçe Petrovit.48 Këto nuk janë pozita të përhershme; ato luhaten në varësi të sfidave të sigurisë duke u diskutuar në takime të veçanta.

Këshilli Lokal për Preventivë në komunën e Gjorçe Petrovit për vitin 2010 është takuar dy herë,-tri herë në vitin 2011, dy herë në 2012 e 2013 bashkë dhe vetëm një herë

43 Përgjigje përmes postës elektronike nga një kërkesë për t'u takuar me anëtarë të Këshilli Lokal për Preventivë të Komunës së Aerodromit, Shkup, pranuar më 17.12.2014.

44 Gjetje nga një diskutim në tryezën e rrumbullakët të mbajtur më 22 qershor të vitit 2015.

45 Mjeti është platformë onllajn ku qytetarët mund të parashtrojnë ankesa anonime sipas dëshirës në linkun vijues: http://service.aerodrom.gov.mk/

46 Intervistë me Marjan Kelemen, nëpunës i zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Aerodromit, e bërë në qershor të vitit 2015.

47 Intervistë me Sabit Shabanin, anëtar i Këshillit të Komunës së Çairit, e bërë më 7 maj 2015, në Shkup.

48 Komuna e Gjorçe Petrovit, informacion i marrë në suaza të Ligjit për Qasje të Lirë ndaj Informacioneve Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 10-09/1.

në vitin 2014.49 Sa i përket Komunës së Çairit, në vitin 2014 u takuan vetëm një herë. Sipas intervistave me dy anëtarët nga Këshilli Lokal për Preventivë, njëri tha se në vitin 2014 Këshilli ka mbajtur 3 takime50, derisa i dyti tha se nuk kanë asnjë informacion se a është takuar Këshilli në vitin 2014 për arsye se nuk ka qenë i informuar apo i ftuar në ato mbledhje. Sipas anëtarit të dytë të Këshillit, arsyeja mund të jetë se disa nga anëtarët që nuk janë të lidhur politikisht me partinë e kryetarit të komunës janë lënë jashtë qëllimisht dhe kështu kanë qenë të painformuar rreth punës së Këshillit Lokal për Preventivë.51 Mungesa e të pasurit rregullore të qartë të punës së KLP-ve mund të kontribuojë në këtë hutim. Disa nga këshillat kanë miratuar praktikën në thirrjen e anëtarëve vetëm për këto takime kur fusha e tyre e ekspertizës është e nevojshme, ndërsa të tjerët ftojnë të gjithë anëtarët, pavarësisht subjektit të diskutimeve.52

Është shumë e rrallë për Këshillat Lokalë për Preventivë të takohen me këshillat tjerë, edhe pse nganjëherë probleme të sigurisë shpesh mund të ndikojnë në dy komuna. Komuna e Gjorçe Petrovit dhe Këshilli i saj Lokal për Preventivë, për shembull, është takuar disa herë me atë të komunës së Sarajit; kjo mund të shihet si një praktikë e mirë, duke i inkurajuar të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.

Komunat	Shpeshtësia e mbledhjeve				
Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Gjorçe Petrovi	2	3	2	2	1
Çairi	/	/	/	/	1
Aerodromi	/	/	/	/	/

Tabela nr. 1 Shpeshtësia e mbajtjes së mbledhjeve të Këshillave Lokalë për Preventivë në Gjorçe Petrov, Çair dhe Aerodrom.

Takimet rralla të këshillave lokalë për preventivë tregojnë se këto këshilla nuk mund të shihen si organe aktive për adresimin e çështjeve të sigurisë në nivel lokal. Në këtë moment, në gjendjen e tyre aktuale ata mund të shihen më shumë si grupe këshilldhënëse në nivel komunal të cilët do të mund të përdoren për të analizuar raportet e krimit lokal, për të diskutuar çështje të sigurisë emergjente që mund të lindin, të sugjerojnë dhe të identifikojnë fushat që kanë nevojë për më shumë vëmendje nga policia.

Përveç kësaj, anketa jonë ka treguar rezultate shqetësuese se qytetarët e komunave të përzgjedhura nuk janë në dijeni për ekzistencën e organeve të tilla. Vetëm 11.7% kanë dëgjuar për Këshillat Lokalë për Preventivë, 6.7% në Aerodrom, 10% në Çair dhe 18.3% në Gjorçe Petrov. Kjo pason realitetin se Komuna e Aerodromit nuk ka Këshillat Lokalë për Preventivë, ndërsa Këshilli Lokal për Preventivë i Gjorçe Petrovit njihet si këshilli më aktiv në mesin e këtyre tre këshillave të analizuara. Këto rezultate janë konfirmuar nga grupet e

49 Komuna e Gjorçe Petrovit, informacion i marrë në suaza të Ligjit për Qasje të Lirë ndaj Informacioneve Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 10-11/1.

50 Intervistë përmes postës elektronike me anëtar që vjen nga fusha e arsimit nga Këshilli Lokal për Parandalim i Komunës së Çairit, intervistë e mbajtur më 01.04.2015.

51 Intervistë telefonike me një anëtar nga Këshilli Lokal për Parandalim i Komunës së Çairit, e bërë në shkurt të vitit 2015.

52 Gjetje nga diskutim i tryezës së rrumbullakët mbajtur më 22 qershor 2015.

fokusit ku pjesëmarrësit poashtu nuk ishin të njohur me këto organe. Edhe në mesin e atyre që kishin dëgjuar për të, kishte pak njohuri për kuptimin apo rëndësinë e tyre. Një rezultat i tillë mund të tregojë se pushteti lokal në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të mendojë sërish funksionimin e këtyre strukturave dhe, më e rëndësishmja, t'i bëjë ata më të afërt dhe transparentë për zgjedhësit e tyre.




Figura 1. Njohja me Këshillat Lokalë për Preventivë

4.5. Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve

Koncepti i Grupeve Këshilldhënëse të Qytetarëve u prezantua në Maqedoni për herë të parë përmes një konference pune për policimin në bashkësi të mbajtur në maj të vitit 2002, organizuar nga Njësia e Zhvillimit të Policisë, të OSBEsë.53 Këto grupe mund të formohen mbi baza vullnetare, me nisma qytetare për ti ndarë shqetësimet e përbashkëta për sigurinë e tyre. Ata janë të përbërë nga policia dhe qytetarët, gjë që ua lejon qytetarëve për të bërë pyetje direkte që kanë të bëjnë me sigurinë përfaqësuesve të kualifikuar të cilët janë në gjendje të japin përgjigje dhe të punojnë së bashku për zgjidhjen e nevojave të sigurisë lokale.

Grupet për Këshilldhënëse Qytetarëve janë një formë e bashkëpunimit që lejojnë qytetarët dhe policinë të punojnë së bashku për të gjetur zgjidhje të bazuara në linja të hapura të komunikimit. Kjo merr formën e takimeve të rregullta me qytetarët dhe "ditët e hapura" për diskutimet mbi çështjet e sigurisë që mbahen qoftë në zyrat komunale apo stacionet policore. Përpjekja këtu është që të përmirësohet besimi në mes dy organeve dhe të krijohet një marrëdhënie proaktive. Duke marrë parasysh frekuencën e ulët të mbledhjeve të Këshillave Lokalë për Preventivë të komunave, Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve konsiderohen si një lidhje e drejtpërdrejtë midis policisë, komunave dhe qytetarëve për të diskutuar çështjet lokale të sigurisë.

Këto grupe të qytetarëve janë parashikuar të takohen rregullisht me policë nga stacionet lokale për të diskutuar çështje me interes të përbashkët dhe të kërkojnë zgjidhje për problemet lokale dhe për të diskutuar tema të tilla si: siguria e trafikut, krimit, rendit

53 Bazat e policimit parandalues, Rozalita Dojçinovska, Departamenti për Parandalim, SPB Shkup, 2013.

publik dhe paqes, duke ndihmuar dhe mbështetur viktimat dhe grupet e rrezikuara etj. Ata janë të vendosura në të gjitha komunat e qytetit të Shkupit –sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme identifikojnë se Departamenti për Preventivë ka formuar 68 Grupet Këshilëdhënëse të Qytetarëve në Qytetin e Shkupit, gjatë periudhës 2010-2014.54 Megjithatë, ky mekanizëm i policimit në bashkësi nuk është i rregulluar me ligj, gjë që sjell konfuzion në mesin e qytetarëve dhe autoriteteve. Edhe në qoftë se ka interes në angazhimin nga ana e qytetarëve për aktivitete të tilla, ekziston një mungesë e të kuptuarit se si duhet të procedohet. Për shembull, 85% e qytetarëve që morën pjesë në anketën e Analyitikës dhe 100% e grupit të fokusit55 as që e dinin se ekziston mundësia e grupeve këshilldhënëse (Shih Fig. 2 më poshtë). Prandaj, ekziston një nevojë e aktiviteteve ndërgjegjësuese të cilat do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në edukimin e publikut mbi mekanizmat e ndryshëm të cilat ata mund të përdorin për të adresuar pyetje të caktuara që ndikojnë në sigurinë e tyre personale apo të bashkësisë.

Mungesa e shqyrtimit legjislativ gjithashtu ndikon në atë si krijohen dhe operojnë Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve, në fund duke e ndikuar idenë bazë prapa ekzistencës së tyre. Për shembull, Komuna Gjorçe Petrov u përgjigj se ka Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve në gjithë komunën, e cila është diçka që ofron mbulim të madh dhe qasje të lehtë në platforma për të diskutuar çështjet lokale të sigurisë. Për shkak të territorit të saj të gjerë, komuna e Gjorçe Petrovit shtrihet edhe në fusha rurale; kjo është arsyeja pse kjo komunë ka vendosur të shfrytëzojë strukturat ekzistuese të quajtura Bashki Rurale/Urbane të përhapura në të gjitha komunat dhe të krijojë Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve.

Funksionalisht, Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve janë të ngulitura tani brenda këtyre aktivitete ditore të Bashkive Rurale/Urbane.56 Logjika prapa kësaj marrëveshjeje ishte për të lehtësuar funksionalitetin dhe për të siguruar që problemet lokale të sigurisë adresohen në nivel lokal nga një organ lokal, se sa në një nivel më të gjerë komunal. Siç tha një zyrtar: "Pse t'i mërzisim përfaqësues nga një pjesë e komunës me problemet lokale të sigurisë të një pjese tjetër të komunës?"57 Megjithatë, ideja prapa Grupeve Këshilldhënëse të Qytetarëve është që të kemi më shumë një qasje nga poshtë-lart, në vend të lart-poshtë. Me fjalë të tjera, manifestimi ideal i një Grupi Këshilldhënës të Qytetarëve do të jetë formuar prej qytetarëve që jetojnë në zonë më të vogël (disa rrugë) të cilët janë të prekur nga një lloj i çështjeve të sigurisë lokale dhe që do të ndërlidhen me policinë lokale dhe komunën në kryerjen e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes rreth llojevetë ndryshme të krimeve dhe/ose thirrje autoriteteve që të kenë vëmendje të veçantë për fusha të veçanta në atë lagje.

54 Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë të Informacioneve Publike në prill të vitit 2014, kërkesa nr. 109/14.

55 Nga diskutimet e grupit të fokusit në komunat Çair, Aerodrom dhe Gjorçe Petrov; janar 2015, Shkup.

56 Intervistë me Zyrtar nga Komuna e Gjorçe Petrovit, e bërë më 8 prill 2015.

57 Po aty.




Figura 2. Njohja me Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve

4.6. Prezentim tabelar i analizës SWOT të modelit aktual të policimit në bashkësi në Shkup

Pikat e forta	Dobësitë
· Kornizë e kënaqshme ligjore · Partneritete ndërmjet policisë dhe bashkësive të caktuara · Transformimi organizativ në nivel të avancuar · Sektori për Punë të Brendshme Shkup i përfshirë aktivisht · OSBE-ja përkrah projektet e policimit në bashkësi	· Strategjia për punën parandaluese të policisë është e klasifikuar, kurse planet aksionale për punën parandaluese të policisë nuk janë në dispozicion · Nuk ka raportim të qartë me korniza kohore · Mbledhje jo të shpeshta të KLP-ve · Nuk ka trupë mbikëqyrës dhe raportues · Mungesë transparence që rezulton në përfshirshmëri më të vogël · Mungesë e vetëdijes ndër popullatë për mekanizmat ekzistues për të adresuar shqetësime për sigurinë · Modeli i policimit në bashkësi në disa komuna është i zhvilluar dhe aktiv, kurse në të tjera më pak
Mundësitë	**Kërcënimet**
· Përdorimi i potencialit të plotë të partneriteteve të caktuara të bashkësisë · Normë më e lartë përfshirjes së qytetarëve · Kampanjë për ngritjen e vetëdijes për trupat ekzistues të bashkësisë	· Vonesa në riaktivizimin e Këshillave Lokalë për Preventivë · Sektori për Punë të Brendshme nuk investon në mënyrë të barabartë dhe proporcionale në zbatimin e modelit të policimit në bashkësi në të gjitha komunat

5. Studim rasti: Komuna e Aerodromit, e Gjorçe Petrovit dhe e Çairit

Për qëllim të këtij vlerësimi ne kemi zgjedhur për të analizuar dhe krahasuar gjetjet nga tri komuna në Shkup, gjegjësisht të Aerodromit, të Çairit dhe të Gjorçe Petrovit. Edhe pse këto tri komuna kanë ngjashmëri në lidhje me madhësinë e popullsisë, ato ndryshojnë në dendësi dhe madhësi të territorit, ashtu si edhe në përbërjen etnike. Për shembull, Çairi dhe Aerodromi të dyja kanë përafërsisht rreth 70.000 banorë, por ato ndryshojnë në shtrirjen urbane – Aerodromi ka shtrirje më shumë se 20 km258, gjersa Çairi është rreth 4 km2.59 Gjithashtu, Aerodromi është i banuar kryesisht me maqedonas etnikë, ndërsa Çairi përbën një shumicë shqiptare. Gjorçe Petrovi, relativisht, është një komunë pak më e vogël me rreth 40.000 banorë dhe përbërja e tij etnike është pak më e ndryshme se ajo e Aerodromit, por ajo është ende kryesisht me maqedonas etnikë.60

Për më tepër, kur analizohen gjetjet nga sondazhi i opinionit dhe grupet e fokusit në këto tri komuna, duhet të merren në konsideratë aktivitetet e kryera nga Sektori për Punë të Brendshme në këto lagje. Në përputhje me këtë, në komunën e Çairit ne nuk mund të identifikojmë grupet e lartpërmendura të sigurisë-partneritetit midis policisë dhe qytetarëve që janë parë në dy komunat tjera, siç janë klubet apo qendrat e preventivës dhe nuk u zbuluan Grupe Këshilldhënëse për Qytetarët. Aktivitetet e SPB Shkup në komunën e Çairit identifikohen vetë në fushata të rastit për preventivë, por asgjë sistematike nuk është duke u zbatuar.

Të dhëna statistikore ndër vite	2012					2013					2014				
Stacioni policor	SPB Shkup	SP Çair	SP Bit Pazar	SP Gjorçe Petrov	SP Aerodrom	SPB Shkup	SP Çair	SP Bit Pazar	SP Gjorçe Petrov	SP Aerodrom	SPB Shkup	SP Çair	SP Bit Pazar	SP Gjorçe Petrov	SP Aerodrom
Totali i veprave penale	15857	1397	1692	1145	1633	16431	1519	1701	1295	2008	12503	1315	1353	1180	1283

Figura 3.

Megjithatë, kur krahasojmë normat e krimit për vitin 2014 në këto tri komuna, numri i veprave penale që ndodhin në komunën e Çairit janë më të larta se numri i veprave penale në të dy komunat tjera së bashku.61 E njëjta gjë mund të shihet në komunën e Gjorçe Petrovit, ku norma e krimit është më e ulëta62 dhe gjatë hulumtimit kjo komunë u karakterizua si njëra që ka bashkëpunimin më aktiv në mes të qytetarëve, të policisë dhe të komunës.

58 Uebfaqja e komunës së Aerodromit, informacioni i përgjithshëm: http://www.aerodrom.gov.mk/portret-na-opshtinata.html, i qasur më 03.06.2015.

59 Uebfaqja e komunës së Aerodromit, informacioni i përgjithshëm: http://cair.gov.mk/pozita.html, i qasur më 03.06.2015.

60 Uebfaqja e komunës së Gjorçe Petrovit, demografi:

61 Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë për Informacion Publik në prill të vitit 2015, kërkesa nr. 172/15.

62 Po aty.

5.1. Përfshirja e qytetarëve në çështjet e sigurisë

Analiza e përfshirjes së qytetarëve në policimin në bashkësi fillon me nivelin e angazhimit të qytetarëve në çështjet e sigurisë në lidhje me komunitetet e tyre lokale. Gati se një e katërta e qytetarëve të anketuar janë përgjigjur se janë të angazhuar në nivel lokal; rrallë mundej të gjendeshin qytetarë që kanë marrë pjesë në veprime të tilla të bashkësisë. Edhe kur përgjigjeshin pozitivisht, ishte e rrallë të gjendeshin shembuj konkretë të angazhimit. Numrat ndryshojnë në mes të grupmoshave dhe është e qartë se qytetarët që kanë qenë më të vjetër se 50 vjeç janë më të interesuar në këto çështje – 45,2% u përgjigjën se ata të angazhohen në çështjet që lidhen me sigurinë brenda bashkësisë së tyre. Përveç kësaj, gjysma e atyre që janë përgjigjur "po" kanë arsimim universitar.




Figura 4.

Gjatë grupeve të fokusit, qytetarët kritikuan mungesën e bashkëpunimit me fqinjët dhe mungesën e dëshirës për të zgjidhur problemet e përbashkëta në lagjen e e tyre, e cila dekurajon ata të besojnë në aktivitete të suksesshme të përbashkëta. Për më tepër, ka pasur një nivel të pesimizmit që, edhe nëse ata iniciojnë diçka, ajo nuk do të japë rezultate në drejtim të përmirësimit të situatës. Specifikat lokale u reflektuan në diskutimet gjatë grupeve të fokusit – qytetarët e Çairit gjetën mirëkuptim më të mirë me fqinjët e tyre pasi ata kishin të afërmit familjar dhe miqtë e ngushtë për fqinjë. Megjithatë, prap nuk ka pasur gatishmëri për angazhim. Në anën tjetër, qytetarët e Aerodromit, që kryesisht jetojnë në apartamente, bëjnë një mënyrë jetese më individualiste dhe nuk ishin të kënaqur, për shembull, me funksionimin e këshillave të banesave. Megjithatë, nuk janë regjistruar raste të iniciativave të suksesshme në këtë komunë, si reagime të përbashkëta për të luftuar ndotjen e ajrit në rritje. Niveli i angazhimit apo gatishmëria për angazhim ishte më e ulëta në komunën e Gjorçe Petrovit. Vlen të theksohet se ka ekzistuar hutim në mesin e këtyre intervistave në lidhje me konceptualizimin – shumë menduan se me angazhimi i tyre në çështjet e sigurisë ata do të ndërhyjnë në punën e policisë dhe shumë prej tyre nuk mund të konceptojnë se si ata mund të angazhohen në punët e tilla si qytetarë të zakonshëm.




Figura 5.

Pasi diskutuam në detale me çfarë lloj të rrezikut të sigurisë merren në komunat e tyre përkatëse, pyetja se përfshirja e qytetarëve a është e nevojshme ne ende mund të shohim se shumica e qytetarëve nuk e shohin veten duke marrë një rol aktiv. Më shqetësuese janë rezultatet nga Gjorçe Petrovi, ku 100% e të intervistuarve në hulumtimin e opinionit shprehën mosbesimin e tyre se bashkëpunimi fqinjësor mund të përmirësojë sigurinë në bashkësitë e tyre përkatëse. Komente nga grupi i fokusit shpjeguan situatën si "gjithkush ankohet, por askush nuk mbështet iniciativa", si dhe "nuk ka solidaritet mes njerëzve pasi ata janë shumë të politizuar dhe një grup nuk e mbështet tjetrin, kur ata vijnë nga parti të ndryshme politike."63

Në mënyrë të ngjashme nga grupi i fokusit në Aerodrom, një nga pjesëmarrësit sugjeroi se iniciativa qytetare do të ishte e suksesshme vetëm nëse ndonjëri nga qytetarët lokalë do të dinte njerëz me ndikim që punojnë në komunë ose në polici.64

Grupi i fokusit i Çairit tregoi një mungesë të bashkëpunimit ndërmjet fqinjve që janë me prejardhje të ndryshme etnike. Komentet ishin "ne jetojmë së bashku shumë mirë, por kur kemi për të marrë iniciativa të përbashkëta nuk besoj se ne mund të bashkëpunojmë" dhe një individ i cili jeton në një kompleks të madh apartamentesh ka deklaruar se ajo nuk i njeh fqinjët e saj mjaftueshëm për të bashkëpunuar.

63 Nga grupi i fokusit i Gjorçe Petrovit që ngjau në janar të vitit 2015, në zyrën e Analytica-s në Shkup.
64 Nga grupi i fokusit i Gjorçe Petrovit që ngjau në janar të vitit 2015, në zyrën e Analytica-s në Shkup.




Figura 6.

Një pyetje e rëndësishme në lidhje me figurën e mësipërme është se si qytetarët e shohin rolin e komunës përkundrejt sigurisë lokale. Është e paqartë nëse kuptimi i tyre i rolit të komunës është i kufizuar vetëm me atë të një organi përgjegjës për përmirësimin e çështjeve infrastrukturore apo nëse perceptimi i tyre është më i gjerë dhe ata me të vërtetë e shohin atë si një kanal komunikimi mes qytetarëve dhe policisë.

Sipas gjetjeve tona prej sondazhit, shumica e qytetarëve kanë pritur prej komunës së tyre për të ndërmarrë veprime dhe të ketë një rol kur kërcënimet ndaj sigurisë vijnë nga faktor jonjerëzor, të tilla si ndriçimi i ulët në rrugë, shenja të pamjaftueshme të komunikacionit, ngasësit e pakujdesshëm dhe qentë endacakë.

Por, kur kërcënimet shkaktoheshin nga njerëz, të tilla si plaçkitje, sulme dhe vepra të tjera të rënda të krimit – ata nuk shohin se komuna ka ndonjë rol në përmirësimin e sigurisë së tyre. Kjo shihet vetëm si pjesë e punës së zbatuesve të ligjit, policisë.

Gjetjet nga grupet e fokusit zbuluan një trend të ngjashëm. Megjithatë, shumica e tyre thonin se komuna mund të ketë një rol më të madh në garantimin e sigurisë. Kur njoftoheshin se kryeshefat e stacionit lokal të policisë i raportojnë kryetarit të komunës dy herë në vit, një qytetar në të tridhjetat nga Gjorçe Petrovi artikuloi se atëherë komuna duhet të ketë njëfarëlloj roli, por ajo duhet të jetë më aktive në përfshirjen më të drejtpërdrejtë të qytetarëve në këto çështje.65

65 Pjesëmarrësi nga grupi i fokusit të Gjorçe Petrovit ishte mashkull në të tridhjetat me arsimim të lartë; diskutimi i grupit u mbajt në janar të vitit 2015 në zyrën e Analytica-s në Shkup.

5.2 Siguria lokale




Figura 7.

Në përgjithësi, qytetarët e komunave të analizuara ndihen të sigurt në lagjen ku jetojnë – 77.7% të të gjithë qytetarëve që janë anketuar ndihen plotësisht ose shumë të sigurt. Ata që u përgjigjën se nuk ndihen të sigurt (16,10% tërësisht të pasigurt dhe 6,10% mesatarisht të pasigurt), si arsye përmendën plaçkitjet e sulmet në mëngjes ndaj më të moshuarve, rrugicat e errëta, qentë endacakë dhe vozitja e shpejtë.

Komuna që ndjehej më së paku e sigurt ishte Çairi, edhe pse jo me në një ndryshim të madh në krahasim me komunat tjera. Gjithashtu, ne mund të identifikojmë se rezultatet e hulumtimit të opinionit nga kjo çështje janë në vijë me normat e krimit dhe numrit të vogël të aktiviteteve parandaluese të cilat janë kryer në këtë komunë. Në anën tjetër është Komuna e Aerodromit, ku 83,4% të ndihen të sigurt; Gjorce Petrovi është diku në mes, me një përqindje prej 73,3%. Në këto komuna janë zbatuar më shumë projekte që lidhen me sigurinë dhe fushata ndërgjegjësuese, të cilat mund të shihen si tregues pozitiv i suksesit.

Grupet e fokusit forcuan rezultatet nga sondazhi i opinionit. Pjesëmarrës nga të gjitha komunat konfirmuan se ata ndihen në përgjithësi të sigurt dhe pjesëmarrësit nga Çairi kishin një nivel pak më të ulët të kënaqësisë në aspektin e sigurisë personale. Pjesëmarrësit nga të gjitha komunat identifikuan problemet e përbashkëta të tilla si plaçkitje, çështjet e komunikacionit dhe shkelje së paqes dhe sjelljes së çrregullt. Si çështje specifike, pjesëmarrësit nga Çairi përmendën një dominim të tregtarëve të drogës; pjesëmarrësit e Gjorçe Petrovit u ankuan se komuna nuk është veçanërisht e sigurt gjatë natës, ndërsa qytetarët e Aerodromit ishin shumë të shqetësuar me ndotjen e ajrit të cilën ata e konsiderojnë sigurinë shëndetësore si një pjesë të rëndësishme të sigurisë së përgjithshme njerëzore.

5.3. Njohuritë rreth policisë lokale




Figura 8.

Sipas anketës, në të tre komunat mund të arrijmë në përfundim se polici ende shihet në rolin e tij tradicional, si zbatues i ligjit, i largët për qytetarin e rëndomt. Në pyetjen a e njohin policin e tyre rajonal, vetëm 5% e të anketuarve në komunën e Aerodromit u përgjigjën pozitivisht, derisa në komunën e Çairit ky numër shkoi deri 13.3%.




Figura 9.

Nga ana tjetër, është inkurajuese që pothuajse tri të katërtat e qytetarëve ndihen rehat për tiu qasur ndonjë polici në çfarëdo kohe. Përqindja është më e larta në komunën e Aerodromit (80%) dhe më e ulët në komunën e Çairit (68,3%), por kjo përqindje paraqet

përfaqësim të dy të tretave të qytetarëve që është ende tregues mjaft pozitiv. Nuk ka dallim të madh në mes përgjigjeve të grupmoshave të ndryshme; edhe pse përgjigjet më pozitive janë marrë nga qytetarët e moshës 40-49 dhe pjesëmarrëset femra ishin pak më të hapura sa i përket qasjes ndaj një polici. Një tjetër gjetje inkurajuese mbështetur nga grupet e fokusit është se përkatësia etnike e policit nuk paraqet një faktor të rëndësishëm për qytetarët – e vetmja gjë që kishte rëndësi për ta ishte profesionalizmi.

5.4. Niveli i kënaqësisë me punën e policisë




Figura 10.

Mënyra se si policia po kryen punën e tyre dhe ajo se qytetarët a janë të kënaqur me punën e tyre mund të luajnë një faktor të rëndësishëm në kryerjen e policimit në bashkësi për shkak se ai ka potencial për të ndikuar në metodat e përdorura në zbatim. Kjo është gjithashtu ndikon drejtpërsëdrejti në besimin në zbatuesit e ligjit, si dhe efikasitetin dhe shpërndarjen e rezultateve. Sondazhi sugjeron se nuk ka mospërputhje të mëdha në mënyrën se si qytetarët nga tri komunat ndihen në lidhje me punën e policisë. Gjorçe Petrovi dhe Aerodromi tregojnë rezultate më të favorshme në drejtim të punës së policisë, ku 40% dhe 36.7% përkatësisht të të anketuarve janë të kënaqur plotësisht. Nëse kësaj i shtohet se rezultatet e atyre që janë "të kënaqur" me punën e policisë në këto dy komuna, atëherë më shumë se gjysma (50%) e të anketuarve shohin favorshëm punën e policisë. Komuna e Çairit ka mbetur pak prapa dy komunavetë tjera dhe në anketën tonë nuk ka arritur të kalojnë pragun e 50% të kënaqësisë në mesin e anëtarëve të publikut. Rezultatet e përgjithshme për të gjitha tri komunat sugjerojnë se 51% e të anketuarve janë të kënaqur me policinë e cila përputhet me sondazhin e fundit të kryer nga OSBE-ja në vitin 2014, ku 51% e të anketuarve në nivel kombëtar kanë qenë të kënaqur me punën e tij.[66]

Prapëseprapë, është interesante se gjatë hulumtimit të opinionit shumica e qytetarëve të intervistuar kanë qenë në mëdyshje për të diskutuar arsyet e pakënaqësisë së tyre. Megjithatë, pjesëmarrësit e grupit të fokusit ishin më të hapur për të diskutuar në

66 Policia megjithatë nuk është gjithaq e (pa)dashur. Utrinski Vesnik, 29.12.2014.

hollësi. Për shembull, një pjesëmarrëse në fund të të njëzetave të saj që vinte nga Çairi artikuloi pakënaqësitë e saj, si shkak emëroi reagimin të ngadalshëm nga policia për thirrjet emergjente ose kur raportohen krime, ku ajo dëshmoi një rast kur një polic ka refuzuar të regjistrojë një grabitje duke qenë se orari tij i punës kishte mbaruar për atë ditë dhe ia kaluar kolegut të tij raportimin e krimit, me çka është dashur të pritet që ai të vjen në ndërrim.

Një pjesëmarrës tjetër nga Aerodromi ndau mendimin e tij se policëve duhet t'u mbahen më shumë trajnime në komunikimin me qytetarët, pasi ai mendon se policëve të rinj u mungojnë aftësitë e duhura të komunikimit – e kjo është diçka që poashtu mungon edhe në mesin e policëve më me përvojë.




Figura 11.

Lidhur me këtë çështje, rreth 60% në të gjitha tri komunat u përgjigjën se numri i policëve duhet të rritet. Megjithatë, nga diskutimet në grupet e fokusit mund të tërheqim disa specifika për komunë. Për shembull, nga grupi i fokusit të Çairit, shumica e tyre ndanë mendimin se numri i policisë në lagjen e tyre duhet të rritet; njëri prej tyre tha se ai nuk e di se sa duhet të jetë raporti i numritpolicëpër qytetarë, por ai mendon se për popullatën e Çairit numri i policëve është i pamjaftueshëm.

Në Gjorçe Petrovit, të gjithë 6 pjesëmarrësit kishin përgjigje të ngjashme në lidhje me këtë çështje – ata kërkuan forca policore më efikase dhe më të organizuara. Në Aerodrom, pjesëmarrësit më të vjetër të grupit pozitivisht kujtonin "Pozorrnikarët e Jugosllavisë (policë lokalë të uniformuar) duke patrulluar në rrugët e lagjeve lokale.

Duke cituar një nga pjesëmarrësit e grupit të fokusit të Aerodromit, një grua në pension në të gjashtëdhjetat e saj theksoi "Kur ekzistonin "Pozornikarët". Për çdo lagje emëroheshin nga dy dhe të gjithë i njihnin. Nëse do të ndodhte diçka, ju do ti tregonit atyre dhe të nesërmen problemi do të ishte zgjidhur".[67] Shumë prej të intervistuarve në hulumtimin e opinionit e mirëprisnin idenë e patrullave të rrugës, dhe komuna e Aerodromit deklaroi se do të mbështeste nismë të tillë.[68]

67 Tri diskutime të grupit të fokusit, janar 2015, Shkup

68 Intervistë me Marjan Kelemenin, zyrtar për zhvillim ekonomik lokal në komunën e Aerodromit, e bërë në qershor të vitit 2015.

5.5. Informimi rreth çështjeve të bashkësisë lokale




Figura 12.

Mënyra se si qytetarët informohen për aktivitetet e komunës mund të luajë rol të madh në promovimin e potencialit që qytetarët kanë për angazhimin me çështjet e policimit në bashkësi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur konsiderohet mungesa e vizibilitetit dhe njohja e dy mjeteve më të rëndësishme të policimit në bashkësi në qytetin e Shkupit: Këshillat Lokalë për Preventivë dhe Grupet Këshilldhënëse të Qytetarëve, ku një numër i madh i të anketuarve nuk ishin në dijeni për ekzistencën e tyre.

Kur analizohen gjetjet nga kjo pyetje (fig. 12), secila bashkësi ka treguar rezultate të ndryshme. Për shembull, komuna e Aerodromit boton gazetën e saj lokale për të cilën 66.7% e qytetarëve deklaruan se e lexojnë për tu informuar mbi çështjet e bashkësisë. Për më tepër, në diskutimin e grupit të fokusit gazeta u kritikua se ka qenë shumë e përqendruar në lajme rreth komunës si organ dhe se i mungon material që do të ishte më i orientuar drejt qytetarëve të saj.

Në Gjorçe Petrov dhe Çair, mediumet më të përqafuara për informim ishin radioja dhe televizioni, me një numër të konsiderueshëm të përdoruesve të internetit në komunën e Gjorçe Petrovit. Pjesëmarrësit e rinj nga Gjorçe Petrovi kryesisht informohen për bashkësinë e tyre përmes faqes zyrtare në internet dhe llogarive në rrjetet sociale të komunës. Megjithatë, sipas tyre komuna nuk angazhohet në mënyrë interaktive me qytetarët përmes këtyre kanaleve të internetit dhe kur adresohen problemet publikisht në faqet e mediumeve sociale, shpesh kritikat nuk janë të mirëpritura dhe të pranuara; komentet negative zakonisht fshihen apo cenzurohen.

Mënyra se si qytetarët informohen luan një rol të rëndësishëm në implementimin e policimit në bashkësi dhe është e këshillueshme t'i kushtojë vëmendje diversiteteve kulturore që ekzistojnë nëpër komuna të ndryshme. Një shembull do të ishte Çairi: në hulumtimin e opinionit, 73.3% u përgjigjën se informohen kryesisht nga TVja dhe radioja, por në diskutimet grupit të fokusit, u diskutua se vetëm ngjarjet e mëdha mbulohen në TV. Mënyra e tyre më e zakonshme e marrjes së lajmeve të komunës ishte me tubimet joformale: për meshkujt, kjo ishte më shpesh përmes bisedave gjatë pirjes së kafesë nëpër

kafenetë lokale, ndërsa gratë informoheshin në rrugën e tyre për në tregun e gjelbër ose duke i dërguar fëmijët e tyre në shkollë, gjatë komunikimit me fqinjët.

Në bazë të specifikave të çdo komune, fushatat e policisë duhet të zhvillohen në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje/bashkpunim më i lartë të qytetarëve të saj. Deri më tani komunat lokale nuk shfrytëzojnë mjaftueshëm potencialin që ata mund të kenë me aktivitete të ndryshme të cilat do të funksiononin për promovim të policimit në bashkësi.

Përveç komunave lokale, Ministria e Punëve të Brendshme gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve në lidhje me mundësitë që ata kanë për t'u angazhuar në aktivitete të policimit në bashkësi. Deri më tani, aktivitetet e tyre kanë pasur kryesisht karakter informativ duke raportuar në përgjithësi në lidhje me rezultatin e ngjarjeve. Në Aerodrom ka pasur përpjekje për të adresuar këtë çështje, duke nxitur diskutime në mes policisë lokale dhe qytetarëve për nevojat e sigurisë lokale, në maj të vitit 2014. Ky ishte një shembull pozitiv i cili mobilizoi qytetarët e kësaj komune që të bëhen më e angazhuar në lidhje me këshillat për parandalimin e grabitjeve. Me qëllim të diskutimeve, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi deklaratë për shtyp, kontaktoi gazetat lokale dhe informacionet në lidhje me aktivitetet u botuan edhe në uebfaqen e komunës. Më shumë shembuj të tillë si këta janë të nevojshme në mënyrë që të krijohet një precedent në angazhimin e qytetarëve dhe për të sjellë kohezion të qasjes.

6. Konkluzioni dhe rekomandime

Konkluzioni

Mjedisi shoqëror për bashkëpunim mes policisë dhe qytetarëve është zhvilluar që nga fillimi i viteve 2000 dhe është bërë përparim në krijimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale, organizative dhe njerëzore për implementimin e policimit në bashkësi. Megjithatë, ka ende shumë punë për të bërë dhe përpjekjet e nevojshme për të arritur një zhvendosje nga policimi tradicional në model më shumë të orientuar drejt policimit në bashkësi në Maqedoni.

Për shembull, legjislacioni primar në Maqedoni nuk e përcakton qartë policimin në bashkësi dhe shumica e punës relevante është lënë të rregullohet në dokumentet dytësore dhe përmes strategjive të ndryshme. Prandaj, nuk ka dispozita të qarta ligjore që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe komunave; kjo ka rezultuar jo vetëm në fleksibilitet të lartë, por edhe arbitraritet në rastin e implementimit të aktiviteteve që dalin nga koncepti policimit në bashkësi.

Këshillat Lokalë për Preventivë në qytetin e Shkupit nuk kanë ndërmarrë ende ndonjë detyrë të veçantë ose aktivitet që do të tregojë një rol aktiv në policimin në bashkësi në emër të tyre. Aktivitetet e Këshillave Lokalë për Preventivë deri më tani mund të përshkruhen vetëm në rolin e debatimit dhe diskutimit.

Në një strukturë të pazakontë për policimin në bashkësi, trupi kryesor koordinues i Maqedonisë është Këshilli Shtetror për Preventivë , një trup i përbërë nga zyrtarë të nivelit të lartë, si Kryeministri dhe ministritë tjera që kanë përgjegjësi të zbatimit të ligjit – p.sh. Ministri i Punëve të Brendshme, ai i Vetëqeverisjes Lokale, i Arsimit, i Shëndetësisë, i Drejtësisë, i Transportit dhe Lidhjeve dhe i Financave marrin pjesë në këtë këshill. Ky këshill është i detyruar të takohet së paku dy herë në vit, por nuk dihet nëse ky detyrim është përmbushur apo çfarë është aprovuar apo çfarë temash janë diskutuar në ato takime poqëse ka patur. Mungesa e informacionit rreth aktiviteteve të këtij organi vë në dyshim efikasitetin e saj.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Sektori i saj për Punë të Brendshme mbajnë rolin kryesor dhe përgjegjësinë për zhvillimin e konceptit të policimit në bashkësi pasi ajo i ka të gjitha mjetet financiare dhe logjistike për zbatim. Kjo thekson më tej se komunat lokale nuk kanë linja buxhetore të destinuara posaçërisht për qëllime të policimit në bashkësi dhe, si pasojë, vërejmë një rol më pak aktiv nga ana e tyre.

Departamenti për Preventivë në kuadër të Sektorit për Punë të Brendshme është përgjegjës edhe për trajnimin e policëve në fushën e parandalimit. Megjithatë, struktura e trajnimit është e panjohur, duke përfshirë edhe nëse ka ndonjë përqendrim në aftësitë e komunikimit meqë shumë qytetarë kanë adresuar çështjen e mungesës së komunikimit dhe sjelljes së denjë nga punonjësit e policisë.

Çdo gjashtë muaj, kryetarët e komunave dhe këshillat komunalë marrin raportet e krimit nga komandanti i stacioneve policore lokale. Është e njohur se këto raporte votohen dhe diskutohen gjatë mbledhjeve të këshillit, por është e paqartë se sa prej rekomandimeve

nga këto raporte janë dërguar në polici dhe sa prej këtyre rekomandimeve zbatohen nga policia pasi mekanizma për vlerësimin e raporteve nuk ekzistojnë.

Për më tepër, është i pranishëm fenomeni i tejklasifikimit në institucionet shtetërore që merren me çështjet e sigurisë, si në këtë rast kur plani strategjik për vitet 2013-2015 në rritjen e bashkëpunimit dhe besimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve u tha të jetë dokument i klasifikuar. Kjo mund të shihet si problematike, kryesisht për shkak se qytetarët dhe aktorët tjerë do të përfitonin vetëm nëse dokumentet e tilla janeë të hapura dhe publike.

Përveç kësaj, nuk ka asnjë rregullore të qartë të kompetencave apo përdorimit të burimeve në dispozicion dhe partneriteteve midis pushtetit lokal dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo mund të çojë në aktivitete të paparashikuara duke u trajtuar me një dozë të madhe të fleksibilitetit nga ana e të dyja palëve. Mungesa e kuorumit është zbuluar kur është analizuar shpeshtësia e mbledhjeve të Këshillit Lokal për Preventivë, të cilat në fund të fundit mund të kontribuojnë më tej për funksionimin e përgjithshëm të këtyre këshillave.

Tutje, huti mbi themelimin e Këshillave Lokalë për Preventivë u identifikua sa i përket varësisë së tyre – ose mungesës së tij – në ciklet zgjedhore. Disa komuna, për shembull, bënin rizgjedhjen e anëtarëve një herë në vit, ndërsa të tjerët kishin po të njëjtit antarë që nga fillimi i formimit të tyre. Në anën tjetër, Komuna e Aerodromit nuk ka formuar ende një Këshill Lokal për Preventivë, por përshkroi marrëdhëniet e saj me policinë si shumë aktive dhe të angazhuara.

Më tej, ne kemi identifikuar se Grupet Këshilldhënëse Qytetarëve nuk janë të rregulluara me ligj, por veprojnë si grupe qytetare joformale; kjo vetëm mund të krijojë huti dhe mungesë të të kuptuarit në mesin e qytetarëve, në përdorimin më efektivë të tyre.

Së fundmi, zhvillimi joproporcional i organeve të lartpërmendura dhe të tjera të tilla si qendrat dhe klubet prevenuese theksuan nevojën për zhvillimin e njëtrajtshëm dhë të barabartë në të gjitha komunat.

Rekomandime

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe policinë

- Modeli i mbajtjes së rendit në bashkësi do të përfitonte në mënyrë të konsiderushme nga të qënit i rregulluar ligjërisht. Kjo është veçanarisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për kodifikimin ligjor të marrëdhënieve mes bashkësive lokale dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- Të shfrytëzohen në mënyrë më aktive platformat eksistuese për komunikim, siç janë gazetat ose mediat sociale. Këto të fundit duhet, në mënyrë të veçantë, të përdoren për promovimin e aktiviteteve policore, caku i të cilëve janë gjeneratat më të reja.

- Këshilli Shtetror për Preventivë duhet të mbajë mbledhje rregullisht. Puna e tij duhet të jetë publike dhe e qasshme për të interesuarit. Kjo mund të realizohet përmes deklaratave, njoftimeve për shtyp, ftesave për media etj. Edhe OJQtë, të cilat punojnë në tema të rëndësishme për agjendën e mbledhjes, duhet të ftohen për të kontribuar.

- Ministria e Punëve të Brendshme, së bashku me komunat lokale, duhet të shmangin mbiklasifikimin e dokumenteve, të cilat janë të rëndësishme për policimin në bashkësi. Për shembull, plani strategjik për periudhën kohore 2013-2015 rreth rritjes së bashkëpunimit dhe besimit mes policisë dhe qytetarëve nuk duhet të konsiderohet si i klasifikuar dhe duhet të jetë i hapur për publikun.

- Departamenti për Preventivë në Sektorin e Punëve të Brendshme në Shkup duhet, gjithashtu, të miratojë rregullat procedurale në lidhje me strukturën e të gjitha mekanizmave të policimit në bashkësi, të tilla si funksionimi i Grupeve Këshilldhënëse të Qytetarëve. Këto rregullore duhen të përcaktojnë pyetje të tilla si shpeshtësia e takimeve, palët e përfshira, çfarë bëhet me rekomandimet e pranuara dhe të gjitha këto duhen të jenë publike.

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të përfshihen në hartimin e çdo lloj koncepti strategjik ose dokumenteve të rëndësishme për policimin në bashkësi, në mënyrë që i tërë procesi të bëhet transparent de gjithëpërfshirës.

- Praktikat e mira të Klubeve për Preventivë në kuadër të shkollave mund të zbatohen edhe në shkolla tjera. Për më tepër, është e rëndësishme që nxënësit e përfshirë në aktivitetet e Klubeve për Preventivë të ndërrohen në mënyrë që një numër sa më i madh i tyre të përfshihen në projekte.

- Ka nevojë për aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët, në mënyrë që ata të mund të informohen rreth mundësive për përfshirjen e qytetarëve në punën e policisë, siç ishte themelimi i grupeve këshilldhënëse.

- Të hapen qendra për preventivë në komunat e tjera – veçanarisht të rëndësishme për Çairin, për shkak të densitetit të lartë të popullsisë në këtë komunë , kjo poashtu është e rëndësishme për zonat rurale të Gjorçe Petrovit.

Për komunën e Aerodromit, të Çairit dhe të Gjorçe Petrovit

- Komunat lokale, gjithashtu, duhet të miratojnë rregullat procedurale lidhur me strukturën e të gjithë mekanizmave të mbajtjes së rendit në bashkësi, siç është funksionimi i Këshillave Lokale për Preventivë. Këto mekanizma do të rregullonin pyetje të tilla si shpeshtësia e mbledhjeve, palët e përfshira, sa u përmbahen rekomandimeve dhe duhet të gjitha këto duhen të jenë publike.

- Të inicohet miratimi/ndryshimi i legjislacionit, gjë që do t'i obligonte komunat lokale të marrin pjesë në çështjet e policimit në bashkësi, siç është ligji për vetqeverisje lokale.

- Të ftohen Organizatat e Shoqërisë Civile në punën e Këshillave Lokale për Preventivë.

- Me qëllim zhvillimit të policimit në bashkësi, komunat duhet të dedikojnë linja të veçanta buxhetore.

- Komunat lokale, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, duhet t'i bëjnë publike raportet dyvjeçare të aktiviteteve të policisë lokale dhe krimit lokal për secilën komunë. Komunat, në bashkëpunim me organizatat lokale të shoqërisë civile, duhet t'i identifikojnë anëtarët e bashkësisë, që tashmë janë aktiv në aktivitetet lokale, duke i ftuar ata të marrin pjesë në aktivitete të policimit në bashkësi. Zakonisht këta anëtarë do të jenë vullnetarë, për të shmangur kufizimet buxhetore.

- Përfaqësuesit e këshillave lokale për preventivë duhet poashtu të takohen me antarë nga këshillat lokale fqinje për preventivë dhe të diskutojnë çështje lidhur me sigurinë, gjë që do të ndikonte mbi qytetarët e të dy komunave.

BIBLIOGRAFIA

Legjislacioni

- Ligji për Policinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 114/2006, me amendamente në, G.Z. 145/2012 dhe G.Z. 41/2014
- Ligji për Policinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 133/2008.

Dokumente tjera dhe raporte

- Udhëzime për rregullimin e metodave dhe mjeteve të punës parandaluese, si dhe planifikimin dhe regjistrimin e aktiviteteve parandaluese, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, Shkurt 2013.
- Bazat e policimit parandalues, Rozalita Dojçinovska, Departamenti për Parandalim, Sektori i Punëve të Brendshme në Shkup, 2013.

Publikime

- Cvete Koneska "Maqedonia: Analizat e Kontekstit të Reformave të Sektorit të Sigurisë në Maqedoni 1991-2008" http://analyticamk.org/images/stories/files/cassrm_mk.pdf; Shkup, 2011
- H. I. DeGeneste,: J. P. Sullivan "Policimi në një Bashkësi Multikulturore", Forumi Hulumtues Ekzekutiv i Policisë (FHEP) NW, 1997
- A. Dikici, 'MbajtPolicimi në Bashkësi', Planet Mësimore të OSBE-së, Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup rreth "Futjes së Policimit Multietnik në Maqedoni: Roli i OSBE-së". Uluslararası Hukuk ve Politika
- Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve – "Shërbime të orientuara kah policimi në bashkësi (COPS), Ministria e Drejtësisë e ShBA-ve, n, http://www.cops.usdoj.gov/pdf/vets-to-cops/e030917193-CP-Defined.pdf Washington DC, e botuar për herë të pare në 2012, rishikuar në 2014.
- Liou, Kuotsai Tom, dhe Eugene G. Savage, "Perceptimi i qytetarve për ndikimin e policimit në bashkësi" Raporti tremujor i Administratës Publike, (Public Administration Quarterly) Vol. 20, Nr. 2; 1996
- Trojanowicz Robert C. dhe D. Carter, "Filozofia dhe roli i policimit në bashkësi". East Lansing, MI: Michigan State University Press, 1988
- Reisig Michael D. Policimi në bashkësi dhe i orientuar kah problemi." Krimi dhe Drejtësia, vëll. 39, nr. 1 (2010)
- Brogden Mike, Preeti Nijhar "Modelet dhe qasjet vendore dhe ndërkombëtare të policimit në bashkësi" Routledge 9A&sig=ANxTF1ku6RPuUiiO8eoGH8YjjNE&redir_esc=y#v=onepage&q&f=false, New York (SHBA), 2013

Mediume

- Protestat shqiptare vazhdojnë në Maqedoni, Top Channel, 11.07.2014 – http://www.top-channel.tv/english/artikull.php?id=12286
- Aksionet e Policisë Maqedone në trazirat etnike – Balkan Insight, 23.05.2014 – http://www.balkaninsight.com/en/article/skopje-calm-after-ethnic-riots-over-murder
- Полицијата сепак не е толку (не) сакана [Policia e pa/dëshiruar].Utrinski Vesnik 29.12.2014 http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=CF043B4819614F4F8E9EC908845D0EEF

Faqet e konsultuara në internet

- Faqja e internetit e komunës së Aerodromit, informata gtë përgjithshme: http://www.aerodrom.gov.mk/portret-na-opshtinata.html, Qasur më 03.06.2015
- Faqja e internetit e komunës së Çairit, pozita gjeografike: http://cair.gov.mk/pozita.html Qasur më 03.06.2015
- Faqja e internetit e komunës së Gjorçe Petrovit, Demografia: http://www.opstinagpetrov.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=2352&Itemid=69 Qasur më 03.06.2015
- Platformë mjetesh online për të plotësuar ankesa anonime e Komunës së Aerodromit në dispozicion në: http://service.aerodrom.gov.mk/
- OSBE Shkup: Misioni i OSBE-së në Shkup për ta zgjeruar Projektin e Sigurisë Shkollore, në dispozicion në: http://www.osce.org/skopje/94516 last accesses 04.06.2015
- Ministria e Punëve të Brendshme: Projekti i Sigurisë Shkollore, në dispozicion në: http://www.mvr.gov.mk/vest/35, qasur së fundi herë më: 04.06.2015

Intervista

- Marjan Kelemen, nëpunës për zhvillim ekonomik lokal në komunën e Aerodromit (intervistë personale e zhvilluar në Komunën e Aerodromit, Shkup 01.06.2015)
- Sabit Shabani, anëtar i Këshillit të Komunës së Çairit, (intervistë personale e zhvilluar në Komunën e Çairit, Shkup 07.05.2015)
- Email intervistë me një anëtar nga fusha e arsimit të Këshillit Lokal për Preventivë të Komunës së Çairit, intervista e zhvilluar më 01.04.2015
- Intervistë telefonike me një anëtar nga Këshilli Lokal për Preventivë të Komunës së Çairit, , zhvilluar në Shkurt, 2015
- Intervistë me nënpunës nga Komuna e Gjorçe Petrovit, , intervistë e zhvilluar më 09.04.2015
- Risto Jovanovski, Departamenti për Preventivë i Sektorit të Punëve të Brendshme Shkup (intervistë personale e zhvilluar në zyrën e Sektorit të Punëve të Brendshme, Shkup, Mars 2015)
- Intervistë me një përfaqësues nga misioni i OSBE-së në Shkup, 15 Korrik 2015

Grupet e fokusit

- Diskutime me tri grupet e fokusit ose 18 pjesëmarrësit nga komuna e Çairit, Aerodromit dhe Gjorçe Petrovit. Të tri grupet ishin të balancuara për nga mosha dhe gjinia; pjesëmarrësi më i ri në diskutim ishte 20 vjeç dhe më i vjetri ishte 66 vjeç. Diskutimi u zhvillua në zyrën e Analitikës me temë siguria në bashkësitë e tyre përkatëse.

Pyetësorët e dërguar nëpërmjet Ligjit për Qasje në informata me karakter publik

- 27 kërkesa janë dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 16 kërkesa në Komunën e Aerodromit, 17 kërkesa në Komunën e Gjorçe Petrovit dhe 12 kërkesa në Komunën e Çairit.

MODELI I POLICIMIT NË BASHKËSI NË SHKUP – NGA IDEJA NË REALITET

Autorë: Kaltrina Selimi & Andreja Bogdanovski

analyticamk
www.analyticamk.org

Shkup 2015

